

Në bazë të nenit 22, pragrafi 1 pika 8 dhe neni 36, paragrafi 1 nga Ligji për vetqeverisjen lokale (Gz. zyrtare e Republikës së Maqedonisë „nr 61/04,96/04,67/07,156/09 dhe 47/11/), dhe neni 162, paragrafi 2 nga Ligji për arsimin fillor (Gz. zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr.103/08,33/10,116/10,156/10,18/11,51/11 dhe 6/12,100/12,24/13,41/14,116/14,135/14), Këshilli i Komunës së Kërçovës, në mbledhjen e ___ mbajtur më dt. __. __.2025, e solli këtë:

RR E G U L L O R E

Për metodologjinë e përcatimit të kriterëve për ndarjen e bllok dotacioneve destinuar për shkollat fillore të komunës në rajonin e Komunës së Kërçovës.

Neni 1

Me këtë Rregullore, përshkruhet metodologjia për përcaktimin e kriterëve për ndarjen e bllok dotacioneve, destinuar për shkollat fillore të komunës në rajonin e Komunës së Kërçovës.

Neni 2

Me mjetet nga bllok dotacionet për financimin e veprimtarisë – arsimit fillor, të transferuara nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë të shpërndara në Programin N1 dhe nënprogramin N10 – arsimit fillor, bëhet financim i shkollave fillore të komunës “ Hristo Uzunov”, “ Dr. Vlladimir Polezhinski”, “Kuzman Josifoski Pitu”, “Faik Konica” , “Rexhë Rushit Zajazi”, “Milito Gurra” , “Naim Frashëri”, “Gjergj Kastrioti – Skenderbeu” dhe “Sande Shterjoski”.

Mjetet nga paragrafi 1 i këtij neni, do të shpërndahen në veçanti për secilën shkollë fillore në bazë të të dhënave të dorëzuara paraprake nga ana e shkollave fillore si dhe planeve të tyre vjetore financiare.

Neni 3

Shuma e bruto rrogave të cilat janë llogaritur paraprakisht dhe janë dhënë si detyrë e obloguar sipas numrit të të punësuarëve, janë tërhequr nga kjo metodologji dhe paguehn për secilën shkollë sipas llogarive të dorëzuara për rrogat.

Në rast se një punëtor, nga shkollë e caktuar, shkon në pension dhe ai vend pune nuk plotësohet me punësim të ri mjetet në sasi të bruto rrogës për atë vend pune, në bazë të ekonomicitetit do të shpërndahen në atë shkollë si mjete shtesë në planifikimin e shpenzimeve rrjedhëse.

Me eliminimin e shumës së përgjithshme të bruto rrogës nga të gjitha shkollat nga shuma e bllok dotacionit vjetorë mjetet e mbetura do të shpërndahen tek shfrytëzuesit buxhetor në përputhje me kriterët e caktuar, kështu që gjatë realizimit të planeve vjetore mund të shfrytëzohet dhe llogaria qëllimore 734014039893715.

Neni 4

Shpërndarja e bllok dotacioneve në shpenzimet rrjedhëse sipas shkollave fillore të komunës në shkollat fillore të komunës në rajonin e Komunës së Kërçovës, do të bëhet në bazë të kriterëve si vijon:

- numri i përgjithshëm i nxënësve në shkollë
- numri i nxënësve me nevoja të posaçme
- numri i nxënësve të cilët shfrytëzojnë transport pa pagesë
- puna me ndërresa
- numri i shkollave rajonale
- qëndrimi ditor

Konformë këtyre kriterëve dhe formula

$$N_x = \frac{P_i \cdot Sh_k}{N_p \cdot P_i \cdot Sh_k} \cdot 100$$

Shk – Shkollë

$P_i \cdot N_x$ – Pika e përgjithshme për shkollë

$N_p \cdot P_i \cdot N_x$ – Pika e përgjithshme për të gjitha shkollat

Është bërë klasifikimi sipas matjes së njejt të pikës dhe përcaktimit me përqindje:

ShFK	Pika	Përqindja
“Sande Shterjoski”	37	22.3 %
“ Hristo Uzunov”	13	7.8%
“ Dr. Vlladimir Polezhinoski”	22	13.3%
“Kuzman Josifoski Pitu”	22	13.3%
“Faik Konica”	14	8.4%
“Rexhë Rushit Zajazi”	20	12.0%
“Milto Gurra”	14	8.4%
“Naim Frashëri”	12	7.3%
“Gjergj Kastrioti – Skenderbeu”	12	7.2%

Neni 5

Mjetet nga bllok dotacionet deri te shkollat fillore të komunës në Rajonin e Komunës së Kërçovës, do të drejtohen nëpërmjet Sektorit për çështje financiare të Komunës së Kërçovës cdo muaj, përkatësisht pas transferimit të tyre nga na ae Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

Neni 6

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e radhës nga dita e publikimit në “Fletoren zyrtare të Komunës së Kërçovës”, ndërsa do të zbatohet nga dt. 01.01 deri 31.12-2026.

Nr. _____

Data __.__.2025

K ë r ç o v ë

KRYETARI I KËSHILLIT TË

KOMUNËS SË KËRÇOVËS